PROCESVERBAL I MBLEDHJES DATE 27.08.2026

Sot në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Devoll zhvillohet mbledhja e radhës sipas njoftimit të datës 21.08.2026.

Të pranishëm në sallë: Lindita Cokani, Alfredi Gjata, Ilir Hoxha, Vladimir Kello, Giela Hoxhalli, Imelda Çuçka, Valbona Spaho, Oliver Mulla, Genti Demçolli, Albana Skoti, Festim Kaso, Trifon Meka.

Alfredi Gjata: Vazhdojmë me miratimin e rendit të ditës.
A ka ndonjë konflikt interesi?
Hapet votimi: 0 pro, 12 kundër, 0 abstenim.
Asnjëri nga këshilltarët nuk ka konflikt interesi.

Hapet votimi për rendin e ditës: 12 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Alfredi Gjata: Vazhdojmë me pikën 2:
Miratimi i procesverbalit të mbledhjes, datë 22.07.2026.

Hapet votimi: 11 pro, 0 kundër, 1 abstenim.

Alfredi Gjata: Vazhdojmë me pikën 3, Projektvendim nr. 63, datë 21.08.2026, "Për miratimin e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për bllok-ndihmën ekonomike për muajin korrik 2026".
Nuk ka diskutime.

Hapet votimi: 12 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Vladimir Kello: Unë kam 3 propozime për të bërë.

1. Për sa i përket trotuarit që po bëhet te rrethrrotullimi i Mirasit.
2. Është bërë një kërkesë për sa i përket shpenzimeve të varrimit të të ndjerit Hektor Kraji dhe nuk e di a kanë marrë përgjigje apo jo, dhe a është e realizueshme, sepse është një nga familjet më të varfra në Bilisht.
3. Një shqetësim në lagjen time, mbase edhe në gjithë qytetin e Bilishtit: kalimi i mjeteve të tonazhit të rëndë, mbi 20 tonë. Meqenëse është kryetari i Bashkisë, do të doja disa përgjigje.

Alfredi Gjata: Këto i diskutojmë te pika "Të ndryshme".

Alfredi Gjata: Vazhdojmë me pikën 4, Projektvendim nr. 64, datë 21.08.2026, "Për disa ndryshime në VKB nr. 81, datë 25.11.2025, 'Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore të Bashkisë Devoll'".

Gazmend Malo: Kjo konsiston vetëm në ndryshimin e çmimit të referencës. Efekte financiare nuk ka.

Genti Demçolli: Kjo do të pasqyrohet në vlerën që do të paguajë qytetari, apo në taksimin e faturës së ujit?

Eduard Duro: Jo, nuk ka ndryshime. Thjesht numri i referencës është shënuar gabim.

Genti Demçolli: Meqë jemi këtu, është një taksë mbi mirëmbajtjen e rrugëve rurale; pse duhet të përfshihen të gjithë?

Eduard Duro: Rrugë rurale janë rrugët lidhëse me fshatrat, me të cilat të gjithëve na lidh përditshmëria.

Gazmend Malo: Është tjetër tarifë për tokat bujqësore.

Hapet votimi: 12 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Alfredi Gjata: Vazhdojmë me pikën 5. Projektvendim nr. 65, datë 21.08.2026, "Për shtesën në buxhet sipas shkresës nr. 11214/3 Prot., datë 06.07.2026, nga Ministria e Financave, mbi zbatimin e Aktit Normativ nr. 02, datë 30.06.2026".

Eduard Duro: Dua të bëj një propozim për një ndryshim në një pikë të përmbajtjes.
Ka ardhur një shtesë fondi nga Ministria e Financave që duhet shpërndarë. Propozoj që këto fonde të kalojnë në blerje materialesh për shkollën e Hoçishtit, pasi nuk na mjaftojnë.

Imelda Çuçka: Meqë jam pjesë e arsimit, si drejtoreshë e arsimit që kam juridiksion, edhe pse pjesën e infrastrukturës e ka pushteti vendor, bashkia, unë u kërkoj këshilltarëve ta mbështesin edhe ata, për vetë faktin që në Hoçisht funksionojnë 2 godina shkollore. Njëra nga godinat u vlerësua nga inxhinierët si e papërshtatshme.
Duke qenë se është një shkollë që nuk ka numër të lartë nxënësish, për të bërë një rikonstruksion duhen të paktën 150 nxënës. Edhe nëse kryetari ka bërë një projekt, nuk mund të miratohet. Në bashkëpunim me bashkinë duhet të krijojmë kushtet. Ne kemi rënë dakord të përshtatet njësia administrative, duke krijuar disa klasa me kushtet e përshtatshme.

Eduard Duro: Shpenzimet gjyqësore në këtë PV na kanë dalë sepse një ish-punonjës ka fituar gjyqin në apel dhe ne detyrohemi të dëmshpërblejmë kohën e largimit nga puna.

Vladimir Kello: Për mua është një çështje shumë e rëndësishme, sepse të rinjtë, fëmijët tanë, janë e ardhmja. Nuk diskutohet që shteti shqiptar duhet të jetë shumë i kujdesshëm për sa i përket edukimit. Me sa di unë, shteti ka investuar edhe për 5 nxënës.

Alfredi Gjata: *Hapet votimi : 12 pro, 0 kundër, 0 abstenim.*

Alfredi Gjata: Vazhdojmë me pikën 6. Këtu kemi raportin e Komisionit të Mandateve për sa i përket betimit të këshilltares znj. Elona Limka.
Znj. Elona Limka vendos dorën mbi Kushtetutë dhe betohet.
Hapet votimi: 12 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Alfredi Gjata: Vazhdojmë me 3 projektvendime që nuk janë në rendin e ditës, pasi erdhën me vonesë dhe kryetari i Bashkisë ishte me leje.

Eduard Duro: Njëri nga këto PV, nr. 66, datë 25.08.2026, "Për miratimin e kërkesës së Bashkisë Devoll së bashku me dokumentacionin tekniko-ligjor për akordimin e ndihmës financiare për familjen e z. Xhimi Fezo, banues në fshatin Bitinckë, NJA Qendër Bilisht, banesa e të cilit është djegur pjesërisht".
Është për një rast emergjent, zjarri në fshatin Bitinckë, në shtëpinë e një banori. Vlera është

vetëm për dëmet e konstatuara.
Hapet votimi: 12 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Eduard Duro: Për sa i përket këtyre 2 PV-ve të tjera, nr. 67, datë 25.08.2026, "Për miratimin e bashkëortakërisë nëpërmjet dhurimit të një pjese të kuotës nga shoqëria me përgjegjësi të kufizuar kurila solar shpk dhe autorizimin e kryetarit të bashkisë për nënshkrimin e marrëveshjes për dhurimin e kuotave" dhe PV nr. 68, datë 25.08.2026, "Për miratimin e bashkëortakërisë nëpërmjet dhurimit të një pjese të kuotës nga shoqëria me përgjegjësi të kufizuar bitincka solar shpk dhe autorizimin e kryetarit të bashkisë për nënshkrimin e marrëveshjes për dhurimin e kuotave", janë projektvendime që i kemi miratuar në shkurt dhe tani miratojmë pjesëmarrjen e bashkisë me kuota. Tokat janë akoma të paregjistruara. Ne do të aplikojmë për regjistrimin e pronave paraprakisht. Duhet të marrim certifikatë pronësie nga ASHK, por duhet një projekt për aplikim.
Hapet votimi për PV nr. 67: *12 pro, 0 kundër, 0 abstenim.*
Hapet votimi për PV nr. 68: *12 pro, 0 kundër, 0 abstenim.*

Alfredi Gjata: Te pika "Të tjera" kemi një kërkesë për emërtimin e ambulancës së fshatit Vranisht. Këtë kërkesë do t'ia kalojmë komisionit për ta parë nëse i plotëson kriteret.

Imelda Çuçka: Propozoj ta miratojmë në parim dhe t'ia dërgojmë komisionit.

Genti Demçolli: Komisioni të shohë edhe pjesën e dakordësisë së banorëve.

Alfredi Gjata: Për sa i përket një kërkese për "Qytetar Nderi" për z. Guri Seferi, ne kemi plotësuar numrin e dhënies së certifikatave të nderit që na lejon, 2 në vit. Kështu që do të shtyhet në janar të vitit të ardhshëm.
Gjithashtu, në bazë të kësaj kërkese të bërë në emër të Shoqatës Devolli, anëtarë të kryesisë janë shprehur te shkresa tjetër se nuk janë në dijeni dhe se nuk janë dakord.

Eduard Duro: Nuk ka nevojë të mblidhet kryesia për të bërë një propozim për "Qytetar Nderi". Mjafton edhe një person.

Në sallë vjen z. Petrit Demiraj, i cili shkwmben informacion midis shoqatws Devolli dhe Bashkisw Devoll nw lidhje me vallen Devolliçe.

Gjithashtu flet nw lidhje me aktivizimin e planit pwr hyrjen nw UNESCO.
Lexon kërkesën dhe historinë e valles Devolliçe.

Nuk ka më diskutime.
Mbledhja deklarohet e mbyllur!

Sekretari i këshillit.
Kostandina Braholli.

Alfredi Gjata